



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 10, datë 20.05.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin maj, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 17:07

Data e mbajtjes së mbledhjes : 20.05.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje të gjithëve !

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare ! Të nderuar të pranishëm !

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe të kërkuar nga kryetarja e bashkisë.

Siç jeni vënë dhe në dijeni në rrugë elektronike dokumentacioni Ju ka ardhur, e keni parë.

Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... mungon.....deri tek.... Morena Boja....prezent.....

Kryetar ke 28 këshilltarë në sallë.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit Dorina.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po lexoj pikën e vetme të rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR PJESËMARRJEN E BASHKISË DURRËS NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
---	---

Kjo është pika e vetme e rendit të ditës.

Nëse keni ndonjë koment përsa i përket kësaj pike?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 28 vota pro miratohet rendi i ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin **e kësaj pike**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës, me shumicë votash propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Znj. Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

**Etleva Budini** : Faleminderit Kryetar.

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike me 8 vota pro të 8 anëtarëve të saj vendosi për kalimin për votim në këshill bashkiak të këtij projektvendimi.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Budini.

Përsa i përket kësaj pike kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Me 28 vota pro miratohet pika 1 dhe e vetme e rendit ditës.*

**Për diskutime** ka kërkuar fjalën për diskutim znj. Morena Boja.

**Morena Boja** : Përshëndetje të gjithëve !

Atëherë pyetja ime konsiston në një problematik në procesin e rindërtimit. I dedikohet më së shumti Zyrës së Rindërtimit dhe ka të bëjë me një problematik të një qytetari, i cili në janar të 2022-shit me kërkesë pranë Zyrës së Rindërtimit, duke qënë se nuk i është rindërtuar banesa dhe këshilli bashkiak ka miratuar me datë 30.07.2020 e ka bërë pjesë të procesit të rindërtimit ku ai

do të përfitonte banesën, por ndërkohë në këtë moment që “Ne” flasim, ajo nuk ka përfituar, banesa nuk i është rindërtuar praktikisht. Dhe në këto kushte i gjendur i pastreh dhe pa përfitim të bonusit të qerasë, ka bërë një kërkesë në Zyrën e Rindërtimit ku kërkon që të akomodohet në një nga strukturat e rindërtimit që janë praktikisht në Manëz. Ndërkohë në rrugë joformale i është thënë që kërkesa nuk mund të miratohet. Doja të dija përgjigjen nga Zyra e Rindërtimit pse nuk mund të miratohet, sepse kemi një qytetar që vet këshilli bashkiak i ka dhënë të drejtën të përfitoj nga procesi i rindërtimit, kemi një zonë rindërtimi në Manëz ku ka apartamente të lira dhe kemi një qytetar që praktikisht sot është në mes të katër rrugëve. Kështu që do të doja një përgjigje sepse nuk miratohet dhe çfarë procedure ndiqet në këto raste. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Sa për saktësi Morena doja të kërkoja diçka : Përgjigja është formale apo jo formale?

**Morena Boja** : Jo, ju thashë që i është thënë në rrugë jozyrtare që nuk mund të miratohet, sepse ka bërë një kërkesë me shkrim praktikisht në fund të janarit të 2022-shit, po s’ka marrë përgjigje akoma.

**Ani Dyrmishi** : Kuptova qartë. Besoj që duhet të pres përgjigjen formale, gjithsesi nëse është dikush nga Zyra e Rindërtimit ose Kryetarja.

**Emiriana Sako** : Unë doja të dija, si quhet qytetari që ka shqetësimin se nuk e përmendët. Folët fjalë të përgjithshme.

**Morena Boja** : Atëherë unë po pyes për anën proceduriale, sepse ky rast nuk është i vetmi. Nëse bashkia e Durrësit ka një qytetar në këtë situatë si e menaxhon situatën Zyra e Rindërtimit dhe institucioni praktikisht.

**Emiriana Sako** : Normalisht programi i rindërtimit ka një spektër të gjërë. “Ne” kemi disa mundësi të strehimit, pra të dhënë në bazë të legjisllacionit dhe aktit normativ si dhe VKM-ve që kanë dal pas tij. Jo të gjithë banesat kanë përfunduar nga ndërtimi nga e para, pra programi i rindërtimit të banesave deri më tani kemi përfunduar 270 objekte, pjesa tjetër është në proces. Numri total shkon rreth 700 shtëpia, të cilat do të rindërtohen nga e para po aty ku ishin. Për arsye të ndryshme institucioni i Fondit Shqiptar të Zhvillimit nuk ka patur mundësi t’i ndërtoj për arsye të infrastrukturës apo të dimensionit të vogël të pronës që nuk e zë shtëpinë model dhe pikërisht për këtë arsye është dhënë një mundësi për rindërtimin e banesave nga vet banorët duke ndjekur një sër dokumentash, pra duke u pajisur me lejen e ndërtimit, me një kontratë me firmë të specializuar që do të bëj këto punime. Dhe një pjesë e qytetarëve kanë arritur që ta ndërtojnë vet banesën e tyre nëpërmjet grantit kesh, pra nëpërmjet grantit që kanë marrë, duke u bazuar tek sipërfaqja që kanë patur në dispozicion. Për banesat e reja në njësitë administrative, pra duhet të ketë një argument pse do të transferohet qytetari, jo vetëm sipas dëshirës, por rastet e transferimit janë ...

**Morena Boja** : Jo, nuk janë sipas dëshirës.

**Emiriana Sako** : Të lutem se nuk kam mbaruar.

**Morena Boja** : Në konsultimet që ka bërë me inxhnjer i është thënë që terreni, që aktualisht ka pasur banesën nuk është e këshillueshme që të kalojnë fondet pa bërë një mur rrethues. Konsiderohet që murin rrethues do ta bëj ai që do rindërtoj dhe në këtë rast Fondi Shqiptar i Zhvillimit apo kushdo që do jetë rindërtues sepse do të dalë me një relacion që shiko se në këto kushte nuk do ndërtohet dhe nëse është e nevojshme ky verifikim të bëhet nga departamenti përkatës dhe jo nga qytetari që të sorollatet.

**Emiriana Sako** : Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pra Fondi që ka marrë përsipër këtë këtë kontratë për ta zbatuar thotë në raste të caktuara që kjo banesë nuk ndërtohet për këto arsye dhe duhet të gjejmë zgjidhje tjetër për qytetarin. Pra , gjithsesi “Ne” për rastin që Ju përmendët.....

**Morena Boja** : Dhe për rastin që flasim në fakt.....

**Emiriana Sako** : Morena, të lutem se nuk të ndërpreva, ta mbaroj se nuk është se....

**Ani Dyrmishi** : Morena, të vazhdoj Kryetarja pastaj Ju.

**Emiriana Sako** : Të thashë nuk është debat, por është për të qartësuar për pyetjen, sepse pyetja juaj ishte në vija të përgjithshme, përndryshe nuk do flisja unë do flisnin teknikët domethënë në qoftë se do ishte për një rast specifik. Pra dokumentat që Ju poseidoni për këtë qytetar na i vini në dispozicion, me sa thatë është bërë dhe një ankesë, do të marrë përgjigje me shkrim. Transferimet nuk bëhen më dëshirë, por bëhen në bazë të një argumenti tekniko-ligjor përse i takon dokumentit të pronësisë apo kushteve teknike të ndërtimit të banesës, pasi vet qytetarët që në fillim kanë kërkuar që banesa t’u ndërtohet aty ku ka qënë, kështu që sigurisht duhet që të justifikohet se pse duhet të shkoj nga banesë individuale në, pra ka përfituar ka një vendim këshilli që ky qytetar përfiton banesë individuale atje ku e ka pasur dhe tani qytetari kërkon që të shkoj në zonën e re të Manzës, pra ky tranzit do të duhet të dokumentohet, pra duhet të ketë një dokument. Faleminderit .

**Morena Boja** : Po, por sa është koha e verifikimit të kësaj procedurë, se po flasim për një proces rindërtimi që s’ka nis sot, po ka nis që pas tërmetit. Po flasim për një vendim këshilli të 30 korrik të 2020-s, domethënë përafërsisht para 2 vitesh, çfarë ka bërë në këto 2 vite Zyra e Rindërtimit në verifikimin e ndërtimit të banesave, se i thonë 2 vjet diferencë, se nuk është as 5 ditë, as 2 muaj, as 2 javë.

**Emiriana Sako** : Pikërisht, procesi nuk ka mbaruar.

**Morena Boja** : Se qytetari s’ka pse të presi Fondin Shqiptar të Zhvillimit apo një institucion tjetër t’i bëj analizën e trullit.

**Emiriana Sako** : Pikërisht, qytetari që nuk do të presi ka mundësin e ndërtimit të vet banesës së tij, ta ndërtoj vet banesën nëse nuk pret institucionin. Është një proces dinamik.

Në Durrës do të ndërtohen 2000 apartamente dhe 1000 banesa individuale dhe sigurisht që këto nuk bëhen në 1 ditë, në 2 ditë apo në 1 vit, është një lagje e re, një qytet i ri që është i shtrirë në zona të ndryshme dhe pikërisht se është i shtrirë e bën problemin akoma dhe më kompleks. Kështu që konkretisht për rastin ndoshta pas mbledhjes mund të na lini një emër mbiemër të qytetarit që të kthejmë një përgjigje përse është ankuar.

**Morena Boja** : Në rregull, faleminderit .

**Ani Dyrmishi** : Fjalë tjetër për diskutim s'ka.

Nëse keni mbaruar Kryetare.

**Emiriana Sako** : Po, faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Atëherë faleminderit të gjithëve.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

*Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 5(pesë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI